

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Arjeta Sadiku dhe me sekretaren juridike Ganimete Hasani-Krasniqi, në konfliktin administrativ të paditëses "ELKOS", sh.p.k. P., të cilën me autorizim e përfaqëson A. A., kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Kosovës, në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të palës paditëse, me datën 4 maj 2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar**, kërkesëpadia e paditëses "ELKOS", sh.p.k. P.
- II. ANULOHET** vendimi i të paditurës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Kosovës, në Prishtinë, Nr. A-88/14 i datës 24.09.2014 dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Paditësja "Elkos" sh.p.k. me padinë e datës 7 nëntor 2014 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, përmes përfaqësueses me autorizim, ka kërkuar nga gjykata anulimin e vendimit të të paditurës MMPH Nr. A-88/14 të datës 24.09.2014, me të cilin i është refuzuar si e pabazuar ankesa kundër vendimit nr.05-351-244539 të datës 31.01.2014 të Drejtorisë së Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të Komunës së Prishtinës. Thekson se paditësja pas pranimit të vendimit nga ana e Komunsë së Prishtinës, ka bërë kërkesë tek kjo e fundit, e cila nga ana përmbajtësore ka qenë kërkesë për rishqyrtim për të cilën është dashur të vendoset brenda afatit të paraparë ligjor. Meqenëse Komuna e Prishtinës nuk ka vendosur, paditësja me ankesë i është drejtuar të paditurës duke kërkuar që të marr përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të vendimit për refuzimin me qëllim të ndryshimit të aktit administrativ. Paditësja shton se e paditura, me vendimin tani kontestues nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm se pse kërkesa e paditësit nuk është pranuar si kërkesë për rishqyrtim gjë që rrjedhimisht lë të kuptohet se organi i shkallës së dytë nuk ka vërtetuar si duhet dokumentacionin e paraqitur, respektivisht gjendjen faktike dhe kështu janë shkelur dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën Administrative. Andaj, kërkon nga gjykata që padinë e paditëses ta aprovojë si të bazuar, ndërsa vendimin e të paditurës ta anulojë.

Përfaqësuesja e të paditurës, në përgjigjen në padi të datës 31 gusht 2016 e ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar, me arsyetimin se sipas dispozitave ligjore të LPK-së barra e provës bie mbi paditësin, andaj kërkon nga gjykata që të njëjtin ta obligoj të veprojë konform nenit 99.3 dhe nenit 100 të LPK-së.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, palët janë ftuar me rregull, mirëpo e paditura ftesës së gjykatës nuk iu ka përgjigjur ndërsa mungesën e ka arsyetuar me parashtrësën e datës

02.05.2017. Andaj gjykata konform nenit 41 të LKA-së, seancën e shqyrtimit kryesor e ka mbajtur pa praninë e të paditurës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 4 maj 2017, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: kërkesa e paditësit nr.05-007-92782 e datës 18.04.2014, ankesa e paditësit e datës 13.05.2014, vendimi i Komunës së Prishtinës nr.05-351-244539 i datës 31.01.2014, leja urbanistike e K. Prishtinës 05 .nr350-18630 e datës 30.01.2012, vendimi kontestues i të paditurës nr.A-88/14 i datës 24.09.2014, konkluzioni lëshuar nga e paditura nr.A-88/14 i datës 20.05.2014, përgjigja në padi e datës 31.08.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveq tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveq rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyerave, duhet të jepen domosdoshmërisht arsye për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekun në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetvetën dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt pa u shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pa ndonjë arsyetim të qartë se si është vërtetuar gjendja faktike.

Nga konkluzioni Nr. A-88/14 i datës 20.05.2014 të nxjerrë nga e paditura, vërtetohet se kjo e fundit ka kërkuar nga organi i shkallës së parë, Komuna e Prishtinës, që t'i informojë lidhur me arsyet e mos vendosjes sipas kërkesës së paditëses, ndërsa nuk ka prova të tjera nëse Komuna e Prishtinës ka dorëzuar informacionin e kërkuar. Për më tepër në këtë konkluzion, e paditura e ka pohuar faktin e bazuar në dispozitat ligjore se ankimi mund të bëhet në formë të kërkesës për rishqyrtim ose të ankesës. Ndërsa pretendimet e palës paditëse kryesisht kanë të bëjnë me këtë fakt, se organi i shkallës së parë është dashur që kërkesën e paditëses ta konsideroj kërkesë për rishqyrtim, të cilën e njëjta nuk e ka shqyrtuar.

Organi i shkallës së parë dhe rrjedhimisht e paditura me vendimin kontestues, ka bërë interpretim të gabuar të dispozitave ligjore, me ç'rast kërkesën e paditëses nuk e ka vlerësuar si kërkesë për rishqyrtim të vendimit dhe e ka refuzuar ankesën e paditëses si të pabazuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, organi i paditur nuk ka zbatuar drejtë Ligjin për Procedurën Administrative, nuk ka zbatuar drejtë ligjin material dhe në këtë mënyrë është cenuar ligji në dëm të paditëses, andaj gjykata i aprovoi pretendimet e paditëses dhe vërtetoi një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur në padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike nga ana e të paditurës.

Në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej 30 ditësh, në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, të vërtetoj gjendjen faktike dhe pasi t'i menjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. 2250/14, më datë 4 maj 2017

Sekretarja Juridike
Ganimete Hasani-Krasniqi

G j y q t a r j a
Arjeta Sadiku

Këshillë Juridike:

kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.